

INFORMACION PËR GJENDJEN ME RASTET ME PERTUSIS NË REPUBLIKËN E MAQEDONISË SË VERIUT NË VITIN 2024, DERI MË 12.12.2024

TË DHËNA JAVORE

Në periudhën 06.12-12.12.2024 nuk janë regjistruar raste të reja me pertusis.

Të dhëna kumulative

- Në vitin 2024 deri më 12.12.2024 janë regjistruar gjithsej 1.171 raste me pertusis me incidencë 63,8/100.000 banorë.
- Numri më i madh i të sëmurëve jetojnë në Shkup (70,5%) ndërkohë që raste janë regjistruar edhe në 22 qytete të tjera.
- Në RSM ka tre epidemi aktive, Shkup, Kumanovë dhe Tetovë.
- Numri më i madh i të sëmurëve i përkasin grupmoshës 0-4 vjet (36,9%), ndërsa incidencë më e lartë është regjistruar tek grupmosha nën 1 vjet (1.554,3/100.000).
- Nga numri i përgjithshëm i rasteve (1.171), 742 ose 63,4% nuk kanë qenë të vaksinuar, nuk i kanë marrë të gjitha dozat e vaksinës, ose nuk ka të dhëna për vaksinim.
- Nga rastet që janë plotësisht të vaksinuar, nga pranimi i dozës së fundit ka kaluar mesatarisht 13,7 vjet.
- Në spital janë shtruar 190 persona, ndërsa numri më i madh i tyre (n=167, 87,9%) janë nga 0- 4 vjet, e që kanë qëndruar në spital mesatarisht nga 8 ditë.
- 1.168 raste janë konfirmuar në laborator.
- Nga 29.11-05.12.2024 janë dhënë gjithsej 87.972 doza të vaksinës e cila përmban komponentë kundër pertusis.

Rekomandime

Për ta parandaluar shfaqjen e rasteve të reja të pertusis dhe për ta parandaluar përhapjen e mëtejshme të sëmundjes, është e nevojshme:

- Të rritet mbulimi me vaksinim primar me një vaksinë që përmban komponent kundër pertusis që të mund të arrihet niveli i mbulimit të rekomanduar nga OBSH prej 95%, si në nivel rajonal ashtu edhe në atë lokal, si dhe në nivel kombëtar.
- Për këtë qëllim, në të gjitha pikat e vaksinimit në territorin e RMV-së, është e nevojshme të kryhet një inspektim i përforcuar dhe i vazhdueshëm i personave që i nënshtrohen vaksinimit të rregullt, si dhe të ftohen për aplikim të dozave të nevojshme të vaksinës. Gjithashtu, nevojitet një kërkim aktiv i intensifikuar i personave të paevidentuar, të pavaksinuar dhe të pavaksinuar plotësisht, me qëllim që të ftohen për tu vaksinuar sipas Kalendarit kombëtar të imunizimit.
- Shërbimet epidemiologjike pranë QSHP/NJR në bashkëpunim me ISHSSH të kryejnë kontroll të intensifikuar në pikat e vaksinimit, kontrollin e statusit të vaksinimit të

personave që i nënshtrohen vaksinimit të rregullt, gjetjen e personave të pavaksinuar dhe të pavaksinuar plotësisht.

- Të përforcohet mbikëqyrja epidemiologjike për pertusis. Çdo rast i dyshuar që i plotëson kriteret klinike të definimit të rastit duhet të hetohet epidemiologjikisht, të testohet në laborator, pra të konfirmohet dhe të raportohet pranë institucioneve kompetente.
- Personat e dyshuar/të sëmurë të dërgohen për diagnostikim laboratorik dhe menjëherë të raportohen pranë institucioneve kompetente.
- Të bëhet izolimi i të sëmurëve në institucione shëndetësore ose në shtëpi, e sidomos nëse në familje ka foshnja, fëmijë të vegjël dhe persona të pavaksinuar, të paktën 5 ditë nga fillimi i terapisë me antibiotikë. E njëjta gjë vlen edhe për pacientët/kontaktet e dyshuara të personave të prekur nëse ata pranojnë kimioprofilaksë.
- Të gjithë mjekët amë duhet ta kontrollojnë statusin e vaksinimit të të gjithë fëmijëve deri në 14 vjet gjatë ekzaminimit dhe t'i udhëzojnë për vaksinim të gjithë fëmijët që e kanë lëshuar ndonjë dozë të vaksinës ose që janë të pavaksinuar;
- QSHP dhe ISHP të kryejnë aktivitete edukative dhe promovuese në lidhje me parandalimin e pertusis, pra theksimin e vaksinimit si masën e vetme parandaluese për mbrojtjen e shëndetit të fëmijëve.

Vlerësimi i rrezikut:

Kjo sëmundje në Republikën e Maqedonisë së Veriut është regjistruar me raste sporadike në 20 vitet e fundit (6 mesatarisht).

Rritja e numrit të fëmijëve të pavaksinuar (ulja e mbulimit me imunizimin e detyrueshëm), fushatat kundër vaksinimit, por edhe hezitimi i prindërve në lidhje me imunizimin shkaktojnë rishfaqjen e sëmundjeve të parandalueshme me vakcina në Maqedoni.

Duke marrë parasysh këtë, ekziston mundësia e regjistrimit edhe të rasteve të tjera të reja në të gjithë territorin e Republikës së Maqedonisë së Veriut.

Ekziston një rrezik mesatar për popullatën në rajonet me mbulim të ulët me vaksinim, por ai mund të minimizohet duke i ndjekur rekomandimet e institucioneve kompetente.

Departamenti i epidemiologjisë së sëmundjeve infektive

ISHPRMV

13.12.2024